



## BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, 14 Shkurt 2018

Lënda : Informacion për realizimin e treguesve ekonomiko-financiarë për vitin 2017.

### KËSHILLIT DREJTUES TË RTSH

Zotit Thoma GËLLÇI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM RTSH


Në mbledhjen e datës 14 shkurt 2018, Bordi i Administrimit të RTSH-së, analizoi realizimin e treguesve ekonomko-financiarë për vitin 2017, të cilat po i paraqesim në vijim:

1.Për vitiin 2017, të ardhurat në fakt u realizuan në shumën 2.657.460.000 lekë (përfshirë dhe të ardhurat e trashëguara nga viti 2016, në vlerën 362 milion lekë), ndërsa shpenzimet në fakt u realizuan në shumën 2.516.396.000 lekë, tregues këto që tregojnë për një administrim pozitiv të të ardhurave dhe shpenzimeve, duke përballuar detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i projektit të digjitalizimit dhe të mirëmbajtjes së tij. Në mënyrë të hollësishme këto realizime paraqiten:

#### A.Struktura e të ardhurave të realizuara

Grafikisht struktura me përqindjet e realizimit të të ardhurave paraqitet:

*Grafik 1*



Ndërsa realizimi i të ardhurave në fakt krahasuar me parashikimin për vitin 2017, paraqiten:

Tabela 2

Në 000/lekë

TË ARDHURAT	Plani I Buxhetit Viti 2017	Realizim I Buxhetit Viti 2017
<b>I Financimi nga buxheti</b>	<b>865,000,000</b>	<b>865,000,000</b>
Sherbimi per shqiptaret jashte kufirit	245,000,000	245,000,000
Prodhime filmike, veprimtari artistike mbarekombetare	63,000,000	63,000,000
Orkestra Simfonike e RTSH-se dhe kinematografise	57,000,000	57,000,000
Projekte teknike per futjen e teknologjive te reja	300,000,000	300,000,000
Projekte teknike per futjen e teknologjivete reja investime	200,000,000	200,000,000
<b>II.Të ardhura të Institucionit</b>	<b>1,815,000,000</b>	<b>1,792,460,000</b>
Të ardhura nga taksa aparatit televiziv	1,200,000,000	1,188,660,000
Te ardhura nga Shfrytezimi i Infrastruktures Transmetuese	44,000,000	44,200,000
Reklama,njoftime etj.	80,000,000	76,600,000
Kontrata e Radiobashkëpunimit me Kinën	89,000,000	80,000,000
Të ardhura nga shitja produkteve te veta e te ardhura te tjera	40,000,000	41,000,000
Të ardhura të trashëguara nga vitet e kaluara	362,000,000	362,000,000
<b>TOTALI I+II</b>	<b>2,680,000,000</b>	<b>2,657,460,000</b>

Të ardhurat, në krahasim me planifikimin, janë realizuar në masën 99.2% , dhe këtu ka ndikuar kryesisht mosrealizimi nga e ardhura e tarifës së aparatit televiziv, në vlerën ~11,340,000 lekë, rënia e kursit të këmbimit të llogarisë në dollarë USA që gjatë vitit 2017 reflekton në uljen e të ardhurave nga kontrata e bashkëpunimit me Kinën në vlerën 9 milion lekë.

**I-Të ardhurat nga buxheti janë realizuar në nivelin e planifikuar në programet e financuara nga buxheti i shtetit :**

**a)Në Programin e parë « Bashkattedarët dhe Shërbimi Satelitor », në zbatim të nenit 116/a,b,c të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i cili shprehimisht përcakton “Financimi nga Buxheti i Shtetit” perfshin :**

a) shërbimin e transmetimeve audio për shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë;

b) shërbimin e transmetimeve audio për publikun e huaj;

c) shërbimin e transmetimeve audiovizive për shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë;

është tërhequr financimi në vlerën totale 245,000,000 lekë, bazuar në situacionet mujore të Njësive e strukturave që kryejne këto shërbimeve, si edhe pagesat e kryera për tarifatat e shërbimit satelitor për Eutelsat ,Ses Astra.

**b)Në Programin e dytë « Orkestra Simfonike e RTSH-së », në zbatim të nenit 116/dh të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i cili shprehimisht përcakton “Financimi nga Buxheti i Shtetit”/ dh) Orkestrën Simfonike të RTSH-së dhe kinematografisë, është tërhequr financimi në vlerë totale 57,000,000 lekë , bazuar në situacionet mujore për paga, sigurime shoqerore.**

**c)Në Programin « Projekte Filmike e Artistike », në zbatim të nenit 116/d të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i cili shprehimisht përcakton “Financimi nga Buxheti i Shtetit”/d) Projekte të rëndësishme prodhimi filmik dhe veprimtari artistike të mëdha mbarëkombëtare, të prodhuara nga RTSH-ja; është tërhequr financimi buxhetor në vlerën totale 63,000,000 lekë për aktivitetet si vijojnë:**

Eurosong 2017, Festivali Junior Eurovision, Filmin serial “Ti mund të më quash Xhon”, Festivalin e 56-të Këngës në RTSH dhe programet festive të fundvitit.

**d) Në Programin e « Projekteve Teknike për futjen e Teknologjive të reja », në zbatim të nenit 116/ ç të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i cili shprehimisht përcakton “Financimi nga Buxheti i Shtetit”/ ç) projekte të rëndësishme teknike për futjen e teknologjive të reja për prodhim dhe transmetim; parashikuar si vijon:**

**d.1) Investime në Teknologji në vlerën ~200,000,000 lekë janë realizuar 100%, në dy projekte:**

\*Investime në përshtatje me teknologjinë , për përshtatjen e stacioneve ekzistuese për montimin e teknologjisë digjitale me standartet bashkëkohore; u kryen investime për rikonstruksionin e stacioneve Mide, Tarabosh, Cervenakë, Gllavë, Sopot, Llogara.

\*Investime në Teknologji për data center, për transmetimet satelitore, përmirësim dhe shtim kanalesh satelitore, teknologji dhe studio lajmesh, investim në teknologji transmetimi për kanalet e platformës tokësore NDVB-T2 .

**d.2) Shpenzime për shërbimin e mirëmbajtjes së rrjetit të digjitalizimit etj. në vlerën 300,000,000 lekë,** nëpërmjet të cilës është likuiduar detyrimi kontraktor për shërbimin e mirëmbajtjes së rrjetit të digjitalizimit gjatë vitit 2017, si edhe është kryer likuidimi pjesor i kështit të dytë të kredisë së digjitalizimit.

Ndonëse të gjithë zerrat e financimit janë realizuar 100% , theksojmë këtu se shpenzimet e RTSH-së për këto programe janë në vlera më të larta dhe përballe detyrimit të kryerjes së tyre, RTSH-së i është dashur të përballojë nga fondet e të ardhurave të veta diferenat e pambuluara nga fondet buxhetore.

**II-Të ardhurat e realizuara nga vetë RTSH kanë patur ecurinë si vijon :**

**1.E ardhura nga tarifa e përdorimit të aparateve televizive.**

Të ardhurat nga kjo tarifë janë realizuar në nivelin 99% gjatë vitit 2017, ose e shprehur në vlerë absolute, për 11.340.000 lekë më e ulët nga planifikimi. Arkëtimi i kësaj të ardhure ka përbërë burimin kryesor të të ardhurave të RTSH-së, si përsa i përket vlerës mujore, ashtu edhe kronologjisë së arkëtimit brenda afateve të parashikuara.

**2.Të ardhurat nga shfrytëzimi i infrastrukturës transmetuese të RTSh-së**

Realizimi i këtyre të ardhurave ka qenë konform detyrimeve dhe është kryer brenda afateve të parashikuara në periudhat përkatëse .

Gjatë vitit 2017, si rezultat i mosrealizimit të vënies në funksion të pajisjeve sipas allotmenteve për kontratat e parashikuara në fillim të vitit, duke ndjekur hap pas hapi riskun e mosrealizimit, RTSH-së i është dashur të rishikojë të ardhurat e parashikuara, duke pakësuar me 25,000,000 lekë buxhetin e këtij zëri.

**3.Të ardhurat nga reklamat, njoftimet etj.**

Gjatë këtij viti nuk është arritur të realizohet planifikimi vjetor në masën 4%, ose një mungesë në vlerë absolute prej 3,400,000 lekë. Krahasuar me ecurinë e të ardhurave të realizuara nga ky zë gjatë dy viteve të fundit, realizimi i këtij zëri në vitin 2017 paraqitet me rritje.

**4.Të ardhura nga Koorporata e Përgjithshme e Radio-Televizionit të Kinës për bashkëpunim Ndërkombëtar Tekniko-Ekonomik**

Bazuar në Kontratën e RadioBashkëpunimit në valë të shkurtra midis Shqipërisë dhe Kinës, është realizuar 100% vlera e parashikuar në kontratë prej 700,000 USD gjatë vitit 2017, përfshirë këtu edhe vlera 150,000 USD në formën e grantit, e cila u përdor për pajisje, sipas kërkesave të njësisë të vartësisë.

Diferenca e mosrealizimit, në vlerën 9,000,000 lekë vjen si rezultat i rënies së kursit të këmbimit të monedhës USD me lekun (nga 1 usd=127.20 lekë në parashikimin e fillimit të vitit 2017).

**5.Të ardhura nga shitja e produkteve të veta e të ardhura të tjera**

Të ardhurat e këtij zëri janë realizuar mbi nivelin e planifikuar. Gjatë vitit 2017 në këtë zë janë të përfshira të ardhurat nga kontratat e qerasë së ambjentëve, pajisjeve dhe studiove, nga klikimet e kanaleve të RTSH-së në youtube, shitja e materialeve arkivore, nga rimbursimi i shpenzimeve të radiostacionit të Cerrikut për detyrime nga kontrata e radio-bashkëpunimit në valë të shkurtra midis Koorporatës së Përgjithshme të

Radio Televizionit të Kinës për Bashkëpunimin Ndërkombëtar Tekniko-Ekonomik dhe Drejtorisë së Stacioneve Transmetuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Radio Televizionit.

### 6. Të ardhura të trashëguara nga vitet e kaluara

Të ardhurat e këtij zëri kanë përfshirë gjendjen e të ardhurave të trashëguara në llogaritë bankare të RTSH-së në 1 janar 2017.


### C. Krahasimi i të ardhurave gjatë tre viteve të fundit

Tabela 2

Ne 000/leke

TE ARDHURAT	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
<b>I Financimi nga buxheti</b>	<b>357,000,000</b>	<b>501,927,000</b>	<b>865,000,000</b>
Sherbimi per shqiptaret jashte kufirit	240,000,000	245,000,000	245,000,000
Prodhime filmike,veprimtari artistike mbarekombetare	62,000,000	53,000,000	63,000,000
Orkestra Simfonike RTSH-se dhe kinematografise	55,000,000	57,000,000	57,000,000
Projekte teknike per futjen e teknologjivete reja		146,927,000	500,000,000
<b>II. Te ardhura te Institucionit</b>	<b>2,174,000,000</b>	<b>1,894,994,000</b>	<b>1,792,460,000</b>
Të ardhura nga taksa aparatit televiziv	1,139,000,000	1,342,994,000	1,188,660,000
Te ardh. Shfrytëzimi i Infrastruktures Transmetuese	93,000,000	91,000,000	44,200,000
Reklama,njofime etj.	60,000,000	74,000,000	76,600,000
Kontrata e Radiobashkëpunimit me Kinën	90,000,000	91,000,000	80,000,000
Të ardh. shitja produkteve te veta e te ardhura te tjera	42,000,000	36,000,000	41,000,000
Të ardhura të trashëguara nga vitet e kaluara	750,000,000	260,000,000	362,000,000
<b>TOTALI I+II</b>	<b>2,531,000,000</b>	<b>2,396,921,000</b>	<b>2,657,460,000</b>

### B. Struktura e shpenzimeve te realizuara per vitin 2017 paraqitet si vijon:



Ndërsa realizimi i shpenzimeve në krahasim me parashikimin e vitit 2017, paraqitet:  
Në lekë

Nr	Emertimi	Planifikimi Viti 2017	Realizimi Viti 2017
1	Paga,shperblime ,sig.shoqeror	792,800,000	788,897,000
2	Materiale,lende djegese	51,270,000	49,699,000
3	Projekte filmike,artist.etj & Fondi prodhimit Pavarur	255,000,000	245,190,000
4	Organizma Nderkombetar	120,000,000	119,950,000
5	Sherbime nga te trete	250,910,000	242,464,000
6	Shpenzime udhetime e dieta	78,890,000	78,859,000
7	Shpenzime te tjera operative	52,280,000	51,308,000
8	Investime dhe mirembajtje rrjeti digjitalizimi	664,850,000	649,029,000
9	Shpenzime per interesa dhe keste kredie	414,000,000	291,000,000
	<b>TOTALI</b>	<b>2,680,000,000</b>	<b>2,516,396,000</b>

Nga të dhenat e mësipërme shpenzimet janë realizuar në masën 94%.  
Në mënyrë analitike realizimi i cdo zëri paraqitet si vijon :

**\*Zëri Paga, sigurime shoqërore e shpërblime** është realizuar pothuajse 100%. Gjatë vitit 2017 janë reflektuar ndryshimet strukturore,janë bërë ndryshimet brenda për brenda zërave. Niveli i pagave sipas kategorive ka mbetur i njëjtë.

**\*Zëri Materiale** përfshin shpenzimet për blerjen e materialeve kryesore teknike, materiale ndihmëse dhe lëndë djegëse(karburant). Realizimi i këtij zëri është në masën 97% dhe është realizuar në përqindjen më të lartë në Njësinë Teknike dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të RTSH-së, kryesisht në funksion të të gjitha strukturave të vartësise.

**\*Zëri i projekteve Filmike dhe Artistike & Fondi i prodhimit të pavarur** , përfshin

a) të gjitha shpenzimet për blerjen e të drejtave të transmetimit, dokumentarë, filma, programe sportive, artistike, dhe është realizuar 100% ,në vlerën e parashikuar 225,000,000 lekë.

b)shpenzimet për fondin e prodhimit të pavarur, realizuar në vlerën 20.200,000 lekë nga 30,000,000 lekë planifikuar.Kjo diferencë është më e vogël po të mbajme parasysh që një përqindje e vlerës së kontratës mbetet të realizohet në vitin 2018, me dorezimin e materialeve në Arkivën e RTSh-së.

**\*Zëri i Organizmave Ndërkombetare** përfshin të gjitha shpenzimet që RTSH kryen ndaj organizmave nderkombëtare, si Eutelsat, Ses Astra, për shërbimin satelitor, EBU për pagesat për transmetime në radio, televizion, Aktualitet, të drejta transmetimi të programeve e aktiviteteve të ndryshme artistike dhe sportive. Gjithashtu në këtë zë përfshihen dhe pagesat e kuotizacioneve ndaj organizmave të tjerë ndërkombëtare, Circom, Copeam, Fiat, AFP, Erno etj. Realizimi i këtij zëri gjatë vitit 2017 është në masën 99%.

**\* Zëri i Shërbimeve nga të tretët** përfshin shpenzimet për shërbime të një natyre të përgjithshme që kryhen nga të tretët për funksionimin e përditshëm të veprimtarisë së RTSH, si shpenzimet për energji elektrike, ujë, shpenzimet telefonike, shpenzimet për ruajtjen e sigurisë fizike të objekteve të RTSH, shpenzimet e internetit, qera të ambjentëve, si dhe shpenzime të tjera për të drejten e autorit, prurësin e reklames, shërbimin e fibrave optike, prodhimin e sinjalit tv etj. Realizimi i këtij zëri është në nivelin 97%.

**\*Zëri i shpenzimeve Udhëtim e dieta** është realizuar 100% , në të gjitha njësite e vartësise dhe gjatë vitit 2017 janë bërë edhe ndryshimet brenda strukturave, gjithmonë në vlerën e planifikuar në fillim të vitit.

**\*Zëri i shpenzimeve të tjera Operative** është realizuar në nivelin 98%. Në këtë zë janë përfshirë shpenzimet për pritje e përcjellje në Drejtorinë e Përgjithshme, shpenzimet për honorare në të gjitha drejtoritë e sistemit, si edhe shpenzimet për taksa,tatime etj.

**\*Zëri i shpenzimeve për Investime** është realizuar në nivelin 95%.

Në këtë zë janë përfshirë shpenzimet për investime në teknologji për blerje pajisjesh të ndryshme për transmetimin e sinjalit nga SD ne HD dhe Furnizim-Vendosje materiale teknologjike në studion e Prodhimit Storage, tenderuar në dhjetor të vitit 2016 dhe zbatuar gjatë vitit 2017.

*\*Investime në përshtatje me teknologjinë* , për përshtatjen e stacioneve ekzistuese për montimin e teknologjisë digjitale me standartet bashkëkohore; u kryen investime për rikonstrukcionin e stacioneve Mide, Tarabosh, Cervenakë Gllavë Sopot, Llogara (realizuar nga financimi buxhetor)

*\*Investime në Teknologji* për data center, për transmetimet satelitore, përmirësim dhe shtim kanalesh satelitore, teknologji dhe studio lajmesh, investim në teknologji transmetimi për kanalet e platformës tokësore NDVB-T2 (realizuar nga financimi buxhetor).

Investime janë kryer edhe në Qendrat Rajonale Audiovizive Gjirokastrë, Korçë, Kukës, si edhe rikonstrukcione të pjesshme në arkivë, televizion etj.

**\*Zëri i shpenzimeve të mirëmbajtjes i parashikuar** është realizuar në nivelin 94% ,nga fondet e buxhetit te shtetit. Vlera e parealizuar është fatura e muajit nëntor,e cila mbetej të arketohet nga të ardhurat e vetë RTSh-së, e në mungesë të gjendjes financiare likuidimi u krye në muajin janar 2018.

**\*Zëri i shpenzimeve të kesteve dhe interesave të kredisë është realizuar sipas pagesave të përcaktuara nga Deutsche Bank. Kësti i parë i kredisë u pagua në muajin Shtator 2017 dhe vlera 97 milione lekë nga buxheti i shtetit u lëvrua në muajin dhjetor 2017.**

### C.Krahasimi i Shpenzimeve të RTSH gjatë tre viteve te fundit

Nr	Emertimi	VITI 2015	VITI 2016	VITI 2017
1	Paga,shperblime ,sig.shoqeror	775,500,000	784,345,000	788,897,000
2	Materiale,lende djegese	43,300,000	57,293,000	49,699,000
3	Projekte filmike,artistike,etj	199,200,000	319,685,000	245,190,000
4	Organizma Nderkombetare	112,500,000	108,738,000	119,950,000
5	Sherbime nga te trete	183,900,000	240,630,000	242,464,000
6	Shpenzime udhëtimi e dieta	64,400,000	80,600,000	78,859,000
7	Shpenzime te tjera operative	29,300,000	31,976,000	51,308,000
8	Investime, Mirambajtje rrjeti digj.	818,200,000	460,414,000	649,029,000
9	Shp.interesa dhe keste kredie			291,000,000
	<b>TOTALI</b>	<b>2,225,800,000</b>	<b>2,083,681,000</b>	<b>2,516,396,000</b>

### C.Detyrimet e të tretëve ndaj RTSH-së

Arkëtimi i detyrimeve kontraktore gjatë vitit 2017 ka vazhduar në mënyrë sistematike nëpërmjet bashkëpunimit të strukturave përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të RTSH.

Gjatë vitit 2017 në mënyrë të përmbledhur, sipas informacionit të ardhur, detyrimet debitorë sipas drejtorive, paraqiten në vijim :

#### **1.Problematika në detyrimet e krijuara nga Shfrytëzimi i Infrastrukturës së Transmetimit**

<b>NR</b>	<b>SUBJEKTET</b>	<b>DETYRIMI</b>
1	Ministria Mbrojtjes	288,000
2	Top Albania	1,492,488
3	Plus Communication	569,743
4	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	72,000
5	Banka e Shqipërisë	180,000
6	Sherbimi Informativ Shtetëror	276,000
7	Abisnet	36,000
8	Ideatel	108,000
9	Vodafone	62,500
10	Drejt.Rajon. Kufirit Migrac. Peshkopi	18,000
11	Multiscreen	378,869
12	Guardia di Finanza	36,000
13	Emiliano Hoxhaj Glob TV	372,556
14	Radio Klan	132,279
15	Televizioni Kombëtar Klan	124,517
16	Skorpion shpk radio Maria	215,659
17	Drejtoria Policisw Qarkut Elbasan	60,000
18	Inst.Ekzek.Veprave penale Korce	24,000
19	Drejt.Policise Qarkut Vlore	48,000
20	Kukes Tv	34,593
21	Drejt.Rajon. Kufirit Migrac. Kukes	18,000
22	Drejt.Rajon. Kufirit Migrac.Gjirokaster	18,000
23	Pellumb Maci	36,000
24	Drejtoria Vendore Policise Gjirokaster	18,000
25	Alban Shehu TV Berat	123,316
26	BBC	985,230
	<b>TOTALI</b>	<b>5,727,750</b>

Deri në këtë periudhë janë likuiduar detyrimet e mësipërme nga pjesa më e madhe e subjekteve, e janë dërguar për ndjekje në Njësinë Teknike e Drejtorinë e Marketingut subjektet debitore Multiscreen, Emiliano Hoxhaj, Plus Communication e Top Albania. Gjatë vitit 2017 vlerësohet si pozitive situata përse i takon arkëtimin të detyrimeve brenda afateve kontraktore.

## **2.Problematika në detyrimet e krijuara në Drejtorinë e Marketingut etj.**

<b>NR</b>	<b>SUBJEKTET</b>	<b>DETYRIMI</b>
1	Ogilvy	4,264,750
2	Sigal	3,392,680
3	Ovation Advertising	92,173
4	Unlimited Media	2,894,898
5	EHW	200,000
6	Tema TV	136,070
7	ERT	105,000
8	Landmark Communications	554,400
9	Brunes	33,932
10	Birra Tirana	50,000
11	Spitali Kontinental	100,000
12	Auto master	36,000
13	New Moment	398,559
14	Top channel	60,000
15	ATSH	720,000
16	Coca Cola	266,000
17	Dife Kareci	15,300
18	Raiffeisne Bank	353,225
19	Top Channel	60,000
20	Alfa	63,826
21	Red Bull	112,171
22	Mccain	83,510
23	Dila shpk	100,000
24	Tibo shpk	400,937
25	Paza Projekt	112,500
26	Publicita	34,560
27	Gener 2	1,062,880
28	Pirro shpk	120,000
29	Century 21	132,760
30	Teg	73,994
	<b>TOTALI</b>	<b>16,030,125</b>



Detyrimet e mësipërme janë dërguar në Drejtorinë e Marketingut për njoftimin dhe ndjekjen sipas kontratave të lidhura në këtë drejtori.

Nga detyrimet e tabelës së dytë, për ndjekje mbetet situata me subjektet Ogilvy, ERT, Automaster, Dila, Tema Tv.

### 3. Problematika me subjektet, të cilat janë në proces gjyqësor.

Më poshtë po paraqesim një pasqyrë të subjekteve, të cilat janë në proces gjyqësor, të pritshme për t'u arkëtuar, si edhe subjekte të cilat kanë problematika përsa i takon arkëtimin të detyrimit.

Gjatë vitit 2017 janë ndjekur në Gjykatën e Apelit Tiranë procese gjyqësore të fituar në gjykatën e shkallës së parë kundër debitorëve të RTSH-së, por në vlera më të vogla, si dhe janë hapur disa procese të reja si më poshtë:

#### 3.1 Detyrimet në Proces gjyqësor (në lekë).

<i>Nr.</i>	<i>Subjekte</i>	<i>Detyrime</i>	<i>Gjendja</i>
	<b>Subjekte që janë në përmbaram</b>	<b>4,326,912</b>	
1	Drejtoria Policisë Qarkut Vlore	330,740	Fituar, është në ekzekutim në Zyrën Përmbaramore Vlorë
2	Media Art	134,994	Fituar, dërguar në Përmbaram po nuk i gjendet adresë
3	Centrum Production	375,333	Fituar, është nxjerrë urdhëri i ekzekutimit dhe është dërguar për ekzekutim
4	Kompania MCDR Shiroka	400,000	Fituar, është nxjerrë urdhëri i ekzekutimit dhe është dërguar për ekzekutim
5	Star Airways Albania	157,205	Në proces gjykimi në shkallën e parë
6	Alfatelekom	918,000	Fituar, dërguar në Përmbaram
7	2 AL shpk	815,000	Fituar, dërguar në Përmbaram po nuk i gjendet adresë
8	Menocon internet	292,000	Fituar, është dërguar për ekzekutim
9	Roland Delia	288,000	Fituar në shkallën e parë
10	KESH	499,500	Fituar, është nxjerrë urdhëri i ekzekutimit dhe është dërguar për ekzekutim
11	“ALSAT” sh.a.	116,140	Fituar është nxjerrë urdhëri i ekzekutimit dhe është dërguar për ekzekutim
	<b>Subjekte në Proces gjyqësor</b>	<b>2,887,482</b>	
1	Kelmend	375,000	Në proces
2	Eurosig	2,512,482	Në proces, pjesërisht arkëtuar viti 2017
	<b>Fituar e në proces gjyqësor per t'u arkëtuar</b>	<b>7,214,394</b>	

Gjatë vitit 2017 janë arkëtuar detyrimet nga subjektet Ministria e Mjedisit në vlerën 1,440,000lekë, Dynamic Sound në vlerën 527,836 lekë, Eurosig pjesërisht në vlerën 1,393,518. Vlera e arkëtimit është ~3,362,000 lekë.

**3.2.Detyrimi i subjektit Radio+2 në vlerën 10,064,727 lekë është në proces realizimi kontratë i shkëmbim Shërbim interneti për RTSH,** kontratë e cila gjatë vitit 2017 u rishikua dhe nga një shërbim me vlerë më të madhe, vjen edhe pakësimi i këtij detyrimi që nga viti 2004.

**3.3** Grupi i subjekteve debitore të tabelës së mëposhtme përfshin detyrimin e kërkuar në rrugë gjyqësore për detyrime që i takojnë periudhës 2000-2004, si edhe tabela e dy subjekteve (TV Klan, Top Albania), për të cilat nga Bordi i Administrimit janë dhënë rekomandimet përkatëse Drejtorisë së Përgjithshme të RTSh.

~Procedurat për subjektete Radio Butrinti, Agjensia De&Ca, TVA janë kthyer mbrapsht nga gjykata pasi nuk ekzistojnë si subjekte, ose për subjektin Galaxy është ekzekutuar pjesërisht e më pas nuk gjendet subjekti.

-Subjekti Media 99 ose TV Koba, është fituar procesi dhe është në ekzekutim në përmbarrim privat.

Nr.	Subjektet te fituara ne gjyq pa adrese	Detyrimi
1	Media 99	5,368,500
2	TV Arbëria	11,656,824
3	Radio Butrinti	630,000
4	Agjensia De&Ca	14,224,654
5	Agjensia Galaxy	1,625,000
	<b>Totali i subjekteve</b>	<b>33,504,978</b>

Nr.	Subjektet	Detyrimi
1	Media 6 TV KLAN	3,444,054
2	Top Albania	3,640,624
	<b>Totali i subjekteve</b>	<b>7,084,678</b>

Lidhur me periudhën në vijim, Bordi i Administrimit paraqet këto sugjerime:

1.Të vijojnë kontaktet me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, për një realizim ritmik të të ardhurave nga tarifa e shërbimit për aparatet televizive, sipas programit buxhetor të miratuar, si dhe rakordimi i të ardhurave të realizuara gjatë viteve 2016 dhe 2017.

2.Të informohet Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Financave lidhur me situatën financiare të RTSh-së për vitin 2018, risqet në realizimin e treguesve financiare dhe të kërkojnë burime shtesë të financimit buxhetor.

3.Të vijojnë përpjekjet për tërheqjen e sa më shumë reklamave, njoftimeve, marrë parasysh se RTSh do të jetë transmetuesi ekskluziv i Kupës së Botës në futboll - Rusi 2018.

Nga strukturat e Marketingut dhe të Marrëdhënieve me jashtë, të bëhen përpjekje për shitjen e programeve të realizuar nga RTSh-ja, si dhe atyre që do të realizohen gjatë vitit 2018, si jashtë ashtu dhe brenda vendit.

4.Të vijojë arkëtimi i debitorëve, ku vëmendje të tregohet dhe ndaj atyre me kontrata shkëmbimi. Gjithashtu të vijojnë procedurat ligjore ndaj subjekteve që kanë kaluar të gjithë afatet kontraktore për kryerjen e pagesave ndaj RTSh-së.

5.Të arrihen rezultate konkrete lidhur me të ardhurat që rrjedhin nga shfrytëzimi i sistemit të digjitalizimit, duke vepruar me rigorozitet për shërbimin e ofruar dhe llogaritjen e detyrimeve. Në këtë drejtim, Drejtoria e Përgjithshme e RTSh-së të verifikojë rregullat ekzistuese, me synimin për përmirësimin e tyre drejt një administrimi të plotë e të kontrolluar të shërbimeve që ofron RTSH ndaj të tretëve.

6.Investimet të përqendrohen në ato drejtime, të cilat sjellin përmirësime në cilësinë e programeve të

realizuara nga RTSh, çfarë mund të ndikojë pozitivisht në shtimin e të ardhurave.

7. Në strukturën organizative të mbahet parasysh fakti që të mos sjellë ndryshime të nivelit aktual të shpenzimeve për paga e sigurime shoqerore.

8. Të vijojë puna për hartimin e planit të biznesit të RTSh-së, sipas afateve të përcaktuara në Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm, plan i cili do të shërbejë si një dokument i rëndësishëm për një administrim edhe më efektiv për RTSH-në.

## **BORDI I ADMINISTRIMIT TË RTSH**

Pandi MADHI -Kryetar

Vjollca BRAHO -Anëtare

Albina PULLA -Anëtare

Adriatik BRAÇE -Anëtar